



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 95, datë 21.06.2019

**PËR
PËRSËRITJEN E TRANSFERIMIT TË PËRKOHSHËM TË GJYQTARES
DIAMELA GOXHA NË GJYKATËN E RRETHIT GJYQËSOR KAVAJË**

Këshilli i Lartë Gjyqësor mbështetur në nenin 46 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në vendimin nr. 23, datë 07.02.2019 të KLGJ-së “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit”, i ndryshuar, në vendimin nr. 89, datë 17.06.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe duke mbajtur në konsiderate dhënien e pëlqimit të gjyqtares Diamela Goxha me shkresën nr. 3289, datë 18.06.2019, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës,

VENDOSI:

1. Gjyqtares Diamela Goxha, aktualisht gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, i përsëritet transferimi i përkohshëm, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, për një periudhë deri në 1 (një) vit, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
2. Njoftimin e këtij vendimi gjyqtares Diamela Goxha, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR